



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Departamentit i Auditimit të Institucioneve Qendrore

Adresa: Blv "Dëshmorët e Kombit", nr.3, Tiranë;

E-mail: klsh@klsh.org.al; ëeb-site: ëëë.klsh.org.al

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ___/09/2019

V E N D I M

Nr. _____, Datë _____

PËR

**AUDITIMIN E USHTRUAR NË FONDIN SHQIPTAR TË ZHVILLIMIT "MBI
AUDITIMIN E PËRPUTHSHMËRISË"
për periudhën nga data 01.01.2017 deri në datën 31.07.2019**

Nga auditimi i ushtruar në "Fondin Shqiptar të Zhvillimit", Tiranë, me objekt "Auditim përputhshmërie" për periudhën 01.01.2017 deri më 31.07.2019, mbi përputhshmërinë e veprimtarisë së Fondit Shqiptar të Zhvillimit me kriteret e vlerësimit përfshirë kuadrin ligjor, rregulloret dhe marrëveshjet që lidhen dhe ndikojnë në përdorimin e fondeve/burimeve, nuk u konstatuan devijime/shkelje materiale nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, dhe për sa më sipër japim opinion të pakualifikuar .

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Institucioneve Qendrore, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, si dhe vlerësimet mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të mësipërm, Drejtori i Drejtorisë së Standardeve dhe Kontrollit të Cilësisë dhe Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të neneve 10, 15, 25 dhe 30, të ligjit nr.154/2014 miratuar në datën 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit",

VENDOSA

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit "Për auditimin e përputhshmërisë", të ushtruar në në Fondin Shqiptar të Zhvillimit(FSHZH) "Fondin Shqiptar të Zhvillimit", Tiranë, sipas programit të auditimit 364/1, datë 29.05.2019, për veprimtarinë e institucionit nga data 01.01.2017 deri në 31.07.2019.

II. Të miratoj rekomandimet për përmirësimin e gjendjes dhe të kërkoj marrjen e masave sa vijon:

A. OPINIONI I AUDITIMIT

Opinion mbi përputhshmërinë (i pakualifikuar)

Ne audituam përputhshmërinë e veprimtarisë së Fondit Shqiptar të Zhvillimit (FSHZH), me kriteret e vlerësimit përfshirë kuadrin ligjor, rregullat, rregulloret dhe marrëveshjet që lidhen dhe ndikojnë në përdorimin e fondeve/burimeve të Fondit Shqiptar të Zhvillimit, gjatë ushtrimit të aktivitetit përkatës.

Mbështetur mbi punën audituese në përfundim rezultoi se, në opinionin tonë, aktiviteti i FSHZH-S, me përjashtim të çështjeve të trajtuara në bazën e opinionit të pakualifikuar, është në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e vlerësimit, si dhe me parimet dhe rregullat e aplikueshme

Baza për opinionin e përputhshmërisë

Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (ISSAIs) mbështetur në ISSAI-n 10- Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30- Kodi Etik, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin përputhshmërisë të një institucioni ndërkombëtar, të cilat janë përmendur në ISSAI-n 4000 "Standardi i Auditimit të Përputhshmërisë". Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura, përfshirë këtu edhe Kodin e Etikës së KLSH-së, miratuar me Vendimin nr. 27, datë 20.04.2008, të Kryetarit të KLSH-së. Auditimi ynë përfshin kryerjen e procedurave me qëllim marrjen e evidencave të auditimit mbi ligjshmërinë dhe rregullshmërinë e transaksioneve. Procedurat janë përzgjedhur mbështetur mbi gjykimin profesional të audituesit, përfshirë marrjen në konsideratë të risqeve të mospërputhshmërisë materiale të transaksioneve me kriteret e parashikuara

Nga auditimi mbi përputhshmërinë, sa i takon shkallës së zbatimit nga subjekti Fondi Shqiptar i Zhvillimit të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord (kriteret e auditimit të përputhshmërisë), bazuar në procedurat e kryera dhe evidencën e përfutur u evidentuan në përgjithësi zbatimi i tyre dhe nuk ka raste mospërputhjes materiale për të raportuar. Auditimi i përputhshmërisë në FSHZH është kryer së bashku me pasqyrat financiare dhe audituesi nën gjykimin profesional e të pavarur japin një opinion të pakualifikuar, ku nuk rezultojnë devijimet materiale. Gjithashtu ne besojmë se dëshmitë e mara gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e **Opinionit të pakualifikuar**¹

Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjet nën auditim:

Drejtimi i Fondit Shqiptar të Zhvillimit është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikën, ligjet dhe rregulloret e aplikuar. Stafit drejtues është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me të gjithë bazën ligjore dhe rregullatorë në fuqi.

Përgjegjësia e Audituesve të KLSH-së:

Objektivi ynë lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme mbi përputhshmërinë e aktivitetit të Fondit Shqiptar të Zhvillimit, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, si dhe mbi përdorimin e duhur dhe eficient të burimeve financiare të institucionit. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional në punën audituese.

¹ Audituesi shpreh një opinion të pamodifikuar-pa rezerve kur në gjykimin profesional të tij audituesi nuk ka raste mospërputhjes materiale për të raportuar, kur konkludon ai shpreh një konkluzion të pamodifikuar

Gjithashtu ne krijojmë një ide fillestare mbi kontrollin e brendshëm në mënyrë që të planifikojmë procedurat e auditimit që i përshtaten situatës aktuale.

Ne komunikojmë me drejtuesit ndër të tjera, edhe për planifikimin në kohë dhe përmbajtjen e auditimit si dhe konkluzionet/gjetjet, duke përfshirë edhe të metat e kontrollit të brendshëm, që ne kemi identifikuar gjatë auditimit tonë.

Ne identifikojmë çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin dhe i përshkruajmë ato në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

B. PROPOZIME PËR NDRYSHIME APO PËRMIRËSIME NË LEGJISLACIONIN NË FUQI:

1.Gjetje nga auditimi: *Mbi shpenzimet për qiratë nga auditimi konstatohet se* janë lidhur kontrata për marrjen e ambienteve me qira për “zyra” për ushtrimin e aktivitetit të Vlorë, Korce, Gjirokastër, Shkodër, Peshkopi në qendër dhe degë, ku është rilidhur kontrata në Gjirokastër me subjektet private dhe për të cilat janë paguar për vitin 2017 në vlerën 1,873,202 lekë dhe për vitin 2018 në vlerën 3,665,303 lekë.

Shoqëria për marrjen me qira të objekteve për zhvillimin e aktivitetit në qendër dhe rrethe nuk ka hartuar rregulla apo manualeve për këtë veprimtari, por ato kryhen spontanisht, e për rrjedhojë janë konstatuar mangësi si më poshtë:

-Janë marrë sipërfaqe të mëdha dhe me kosto të lartë që shkojnë deri në 66 mijë lekë në muaj dhe shumë herë më shumë ambiente se sa ka përcaktuar VKM, ndërkohë që ka vetëm 5 punonjës në një rajon, si Shkoder, Vlorë etj.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit i cili ju paraqit grupit të auditimit në lidhje me kontratat e lidhura me subjektet qiradhënëse konstatohet:

-Nuk ka asnjë urdhër të brendshëm për ngritjen e një komisioni për vlerësimin e ofertave të përzgjedhjes së ambienteve për zyrat qendrore

-Publikimi i njoftimit nuk është bërë në ndonjë Gazetë shqiptare, pra në ndonjë të përditshme, duke shmangur dhe oferta të tjera të mundshme. Nuk rezulton asnjë shprehje interesi për marrje me qira për nevoja të FSHZH, në media të tjera të shkruara apo elektronike, si dhe në buletin e APP, që ka sjellë dhe mungesën e ofertuesve në këtë shërbim.

Nuk ka relacion të hartuar për Titullarin me numër protokolli dhe datë, ku të përshkruhen ndër të tjera arsyet e marrjes me qera ,tregu i studiuar si dhe mënyra si janë siguruar ofertat.

Nga dokumentat e vëna në dispozicion nuk rezulton se janë marrë oferta të protokolluara ose jo nga shoqëri ,individë apo kompani imobilare. *Sa më sipër, trajtuar më hollësisht në faqet nr.26-44 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, rekomandojmë:*

1.1.Rekomandimi: Agjencia e Prokurimit Publik ti propozojë Këshillit të Ministrave, amendime të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, të parashikojë mënyrën dhe procedurat që duhet të ndiqen nga Institucionet publike shtetërore për kontraktimin e shërbimit *për marrjen e ambienteve me qera për ushtrimin e aktivitetit*, meqënëse ky shërbim nuk është parashikuar si përjashtim në këtë nen të ligjit “Për Prokurimin publik”, si dhe përgatitjen dhe nxjerrjen e akteve nënligjore rregulluese të kësaj fushe.

C. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Në zbatimin e kritereve në planifikimin e buxhetit, në përputhje me udhëzimet e Ministrisë së Financave për përgatitjen e buxhetit të shtetit dhe zbatimin e tij.

Për vitin 2017, paraqitja e informacionit, si dhe të dhënat e raportuara në **raportin e monitorimit** duhet të jetë në përputhje me përcaktimet e bëra në Udhëzimin nr.22, datë 17.11.2016 “Për procedurat standarte të monitorimit të buxhetit në njësitë e Qeverisjes Qendrore”, specifikisht sipas formateve të përcaktuara në paragrafin 49, të këtij udhëzimi. Vërejmë që të dhënat e raportuara në raportin e këtij institucioni për vitin 2017, nuk janë raporte monitorimi sipas formateve të përcaktuara në këtë udhëzim dhe në anekset përkatëse. Raporti i monitorimit të këtij viti ka të plotësuar vetëm disa nga tabelat e raportimit dhe jo relacionin e tij, ku mungon analiza e mirëfilltë e objektivave të politikës së programit. Për të siguruar paraqitjen sa më mirë të lidhjes midis realizimit të objektivave të politikës së programit me realizimin e treguesve të performancës, si në udhëzimin e mësipërm është e rëndësishme edhe plotësimi i komenteve për secilin tregues për të evidentuar si arrijtjet edhe problematikat.

Pjesë e raportit të monitorimit duhet të jenë edhe shpenzimet e realizuara nga të ardhurat jashtë limitit, si edhe treguesit e performancës së realizimit të tyre. *Sa më sipër, trajtuar më hollësisht në faqet nr.13-26 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, rekomandojmë:*

Rekomandimi 1.1. Nga struktura drejtuese dhe menaxhuese e këtij institucioni, të hartohen raporte monitorimi për të dy aktivitetet (si për fondet buxhetore dhe për fondet nga llogaritë e administratorëve), në përputhje me përcaktimet e bëra në Udhëzimin nr.22, datë 17.11.2016 “Për procedurat standarte të monitorimit të buxhetit në njësitë e Qeverisjes Qendrore”, me qëllim përmirësimin e performancës së përdorimit të këtyre fondeve, ruajtjen dhe administrimin e tyre.

Menjëherë

2.Gjetje nga auditimi: Mbi shpenzimet për qiratë,nga auditimi konstatohet se FSHZH janë marrë ambiente me qira për “zyra” për ushtrimin e aktivitetit të Vlorë, Korce, Gjirokastër, Shkodër, Peshkopi në qendër dhe degë, ku është rilidhur kontrata në Gjirokastër me subjektet private dhe për të cilat janë paguar për vitin 2017 në vlerën 1,873,202 lekë dhe për vitin 2018 në vlerën 3,665,303 lekë.

Shoqëria për marrjen me qira të objekteve për zhvillimin e aktivitetit në qendër dhe rrethe nuk ka hartuar rregulla apo manualeve për këtë veprimtari, por ato kryhen spontanisht, e për rrjedhojë janë konstatuar mangësi si më poshtë:

-Janë marrë sipërfaqe të mëdha dhe me kosto të lartë që shkojnë deri në 66 mijë lekë në muaj dhe shumë herë më shumë ambiente se sa ka përcaktuar VKM, ndërkohë që ka vetëm 5 punonjës në një rajon, si Shkoder, Vlorë etj.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit i cili ju paraqit grupit të auditimit në lidhje me kontratat e lidhura me subjektet qiradhënëse konstatohet:

-Nuk ka asnjë urdhër të brendshëm për ngritjen e një komisioni për vlerësimin e ofertave të përzgjedhjes së ambienteve për zyrat qendrore

-Publikimi i njoftimit nuk është bërë në ndonjë Gazetë shqiptare, pra në ndonjë të përditshme, duke shmangur dhe oferta të tjera të mundshme. Nuk rezulton asnjë shprehje interesi për marrje me qira për nevoja të FSHZH, në media të tjera të shkruara apo

elektronike, si dhe në buletin e APP, që ka sjellë dhe mungesën e ofertuesve në këtë shërbim.

Nuk ka relacion të hartuar për Titullarin me numër protokollit dhe datë, ku të përshkruhen ndër të tjera arsyet e marrjes me qera, tregu i studiuar si dhe mënyra si janë siguruar ofertat. Nga dokumentat e vëna në dispozicion nuk rezulton se janë marrë oferta të protokolluara ose jo nga shoqëri, individë apo kompani imobilare. *Sa më sipër, trajtuar më hollësisht në faqet nr.26-44 të Projekt Përfundimtar të Auditimit, rekomandojmë:*

2.1.Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i FSHZH-s të marrë masa të menjëhershme që në manualin e procedurave të parashikojë në seksionin e “Mjediset e punës së FSHZH” për administrimin e proceseve apo procedurave për marrjen me qira të objekteve për ushtrimin e aktivitetit, për të adresuar qartë detyrat dhe përgjegjësitë e punonjësve të përfshirë në këtë proces.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: *Mbi inventarizimin e aktiveve*, nga auditimi i dokumentacionit të aktiveve të paraqitur nga shoqëria u konstatua se, për periudhën objekt auditimi nuk janë marrë masa të plota për inventarizimin e aktiveve, janë hartuar disa “lista aktiveve të nënshkruara nga disa persona”, formale dhe që nuk i shërbejnë plotësisht procesit të evidentimit dhe ruajtjes së aktiveve. Konstatuam ***që procesi i inventarizimit të aktiveve në këtë shoqëri nuk është kryer ndër vite***, veprim i cili është në kundërshtim me ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” si dhe ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”.

Nga auditimi i Fletëve të inventarit të mbajtura nga komisionet e inventarizimit të aktiveve rezultuan problematikat e mëposhtme:

a. Komisioni i inventarizimit të vlerave aktive dhe detyrimeve të FSHZH nuk kanë mbajtur një procesverbal me përgjegjësin e materiale për të fiksuar numrin rendor të fletëhyrjes dhe fletëdaljes së fundit.

Veprime të tilla bien në kundërshtim me nenin 83 të kapitullit “Përgjegjësitë për inventarizimin” të Udhëzimit nr. 30 datë 27/12/2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik ” në të cilin citohet : *“Para fillimit të inventarit fiksohet numri rendor i fletëhyrjes dhe fletëdaljes nëpërmjet një procesi verbal të mbajtur midis përgjegjësit material dhe komisionit të inventarizimit dhe behet mbyllja dhe dyllosja e magazinës. Hapja dhe mbyllja behet në prani të komisionit dhe përgjegjësit material”*.

Komisioni i inventarizimit të vlerave aktive dhe detyrimeve të FSHZH nuk kanë përpiluar një relacion në lidhje me inventarizimin fizik të aktiveve, për kushtet fizike të ruajtjes së tyre etj. Nga auditimi i fletëve të inventarit të vlerave aktive dhe detyrimeve të FSHZH, rezultoi se këto fletë kanë të plotësuar veten rezultatin e dalë nga inventarizimi. Në këto fletë inventari, grupi i auditimit konstatoi se nuk është respektuar proceduara e inventarizimit sipas udhëzimit 30 datë 27/11/2011, por komisioni është mjaftuar duke marrë të dhënat nga kontabiliteti e duke i cekuar pa dale në një konkluzion në lidhje me gjëndjen reale të inventarit pas përlogaritjes si të amortizimit ashtu dhe mungesave, tepricave të aktiveve. Këto fletë inventari janë të firmosura nga komisioni i inventarizimit të pajisjeve mjekësore me Kryetar znj. M.P.

Veprime të tilla bien në kundërshtim me: nenin 73 të kapitullit “Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve” të Udhëzimit nr. 30 datë 27/12/2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik ” në të cilin citohet : *“Inventarizimi i aktiveve është një element i rëndësishëm i kontrollit në kuadrin e menaxhimit të aktiveve të njësisë, i cili kryhet për të vërtetuar saktësinë, cilësinë e gjëndjes fizike të aktiveve në një kohë të caktuar si dhe përdorimin në*

mënyrën e duhur dhe me eficiencë të tyre. Inventarizimi kryhet nën përgjegjësinë dhe sipas procedurave të miratuara me këtë udhëzim dhe nga titullari i njësisë publike”

me nenin 85 të kapitullit “Përgjegjësitë për inventarizimin” të Udhëzimit nr. 30 datë 27/12/2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, në të cilin citohet: *“Komisioni i inventarizimit ka përgjegjësinë për : Verifikimin fizik dhe cilësor të gjendjes së aktiveve në ngarkim/përdorim të personelit të njësisë publike dhe pasqyrimin e të dhënave të inventarizimit në procesverbalin përkatës, i cili ruhet gjatë periudhës së inventarizimit. Të bëjë krahasimin e gjendjes konkrete të aktiveve me të dhënat përkatëse të librave që mbahen nga punonjësit me përgjegjësi materiale e që janë të përputhura me sektorin e financës, të llogaritë kompensimet e lejueshme, duke marrë edhe mendimin e specialistëve përkatës dhe, për diferencat që mund të dalin pas kompensimeve, të hartojë procesverbalet. Të përpilojë një raport lidhur me inventarizimin fizik të aktiveve, vlerësim paraprak lidhur me cilësinë dhe kushtet e ruajtjes së tyre, gjendjen fizike dhe vërejtjet lidhur me karakterin e diferencave e dëmtimeve të konstatuara, për shkaqet e tyre dhe personat përgjegjës, së bashku me gjithë dokumentacionin e inventarizimit, t’ia dorëzojë për veprime të mëtejshme nëpunësit autorizues”.*

Gjithashtu nga grupi i auditimit u konstatua se nuk është mbajtur asnjë proces verbal pas përfundimit të realizimit të inventarizimit nga ana e komisionit, mbi verifikimin fizik dhe cilësor të gjendjes së aktiveve në ngarkim apo përdorim të personelit të institucionit si dhe pasqyrimin të të dhënave të inventarizimit.

Nga auditimi i listës së aseteve të FSHZH e miratuar nga komisioni i inventarizimit, grupi i auditimit konstatoi se komisioni i inventarizimit në llogaritjen e amortizimit ka zëruar një pjesë të makinave si dhe një pjesë të aktiveve të institucionit, dhe për këto aktive nuk është ngritur asnjë komision për të kryer procesin e rivlerësimit apo të nxjerrjes jashtë përdorimit në kundërshtim me pikë 98 të udhëzimit nr 30 datë 27/12/2011 i cili citon se *“Komisioni i vlerësimit dhe komisioni i nxjerrjes nga përdorimi përgjigjen për zbatimin e ligjshmërisë dhe të kriterëve të miratuara në këtë udhëzim respektivisht për vlerësimin në paragrafin 103 dhe për nxjerrjen nga përdorimi të aktiveve publike në paragrafet 107, 108 dhe 109.*

b. Nga auditimi mbi funksionimin e komisioneve të vlerësimit për nxjerrjen jashtë përdorimi të aktiveve.

Si rezultat i mos përpilimit të raportit lidhur me inventarizimin fizik të aseteve, vlerësimit paraprak lidhur me cilësinë dhe kushtet e ruajtjes së tyre, gjendjes fizike si dhe vërejtjeve lidhur me karakterin e diferencave apo dëmtimeve të konstatuara, *procedura për procesin e vlerësimit të aktiveve si dhe të aktiveve të propozuara për dalje nga përdorimi në njësi nuk është kryer nga institucioni në kundërshtim me udhëzimin nr.30 datë 27.12.2011.*

Është përgjegjësi e titullarit të caktojë kryetarin e komisionit për nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve, komisioni i cili nuk duhet të jetë i përberë në më pak se 5 (pesë) vetë.

Komisionet e Vlerësimit të Aktiveve për nxjerrjen jashtë përdorimi nuk janë krijuar për asnjë nga vitet objekt auditimi.

Veprime të tilla bien në kundërshtim me nenin 100 të kapitullit “Procesi i vlerësimit të aktiveve të propozuara për dalje nga përdorimi në njësi” të Udhëzimit nr. 30 datë 27/12/2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” neni 100 , në të cilin citohet: *“Komisioni i nxjerrjes nga përdorimi përbëhet nga jo më pak se 5 vete, kryetari i këtij komisioni përcaktohet nga Titullari në varësi të kompetencave për nxjerrjen nga përdorimi të dhëna në paragrafët 111 deri 118 të këtij udhëzimi”*

Komisionet e Vlerësimit të Aktiveve për nxjerrjen jashtë përdorimi, nuk kanë pasur një raport të përpiluar nga komisionet e inventarizimit të aktiveve.

Veprime të tilla bien në kundërshtim me nenin 102 të kapitullit “Procesi i vlerësimit të aktiveve të propozuara për dalje nga përdorimi në njësi” të Udhëzimit nr. 30 datë 27/12/2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” në të cilin citohet: *“Nëpunësi*

Zbatues i njësisë, në bazë të gjendjes faktike të aktiveve të rezultuar nga inventarizimi, normave të amortizimit, afatit të skadencës, vitit të vënies në punë, vlerës së shtuar ndër vite, mundësitë për riaftësimin e aktiveve në raport me kosto/ përfitimin për një veprim të tillë, informacionit zyrtar të marre mbi dobishmërinë e aktiveve nga drejtuesit e programeve buxhetore dhe punonjësit e tjerë të njësisë, përcakton gjendjen e aktiveve dhe harton listën e atyre që do të vlerësohen. Lista nënshkruhet nga komisioni i vlerësimit dhe përgjegjësi material dhe hartohet në tre kopje, një nga të cilat qëndron në arkiv”.

Pra në konkluzion, grupi i auditimit për periudhën objekt auditimi konstatoi se institucioni nuk ka kryer inventarizimin e vlerave aktive të institucionit në përputhje me udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësinë e sektorit publik” por është mjaftuar vetë nga të dhënat të cilat janë marrë nga kontabiliteti i institucionit, e duke mos ndjekur procedurën për kryerjen e vlerësimit apo të rivlerësimit për aktivet të cilat janë regjistruar me vlerë të mbetur 0 (zero). *Sa më sipër, trajtuar më hollësisht në faqet nr.26-44 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, rekomandojmë:*

3.1 Rekomandimi: FSHZH, të marrë masa për ribërjen e inventarizimit të aseteve, nxjerrjen e rezultatit të tij, sistemimet e duhura në raste të diferencave, si dhe veprimet e mëtejshme në zbatim të kërkesave të udhëzimit nr. 30, datë 27/12/2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësinë e sektorit publik”, si dhe të nxirret përgjegjësia për veprimet apo mosveprimet e personave të ngarkuar për zbatimin e rregullshmërisë së këtij procesi.

Brenda datës 31.12.2019

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i *Vlerësimi i detyrave të projektimit, të projekteve të zbatimit, preventivave të zbatimit, studimeve sizmologjike apo studime të tjera.*

-Zbatimi i legjislacionit për shpronësimet publike. Marrëdhëniet e Fondit Shqiptar të Zhvillimit me Ministrinë e Linjave, me Njësitë e Qeverisjes Vendore dhe me Komunitetin konstatohet se për vitin 2017-2018 dhe 6 mujori 2019, projektet rezultojnë të janë kontrolluar nga Njësia e Mbeshtetjes Teknike, ku janë konstatuar problematika që lidhen kryesisht me :
-cilesinë e projekteve , për të cilat u është kërkuar NJQV rishikimi i projekteve dhe plotësimin e dokumentacionit për këto projekte por reagimi nga ana e tyre nuk ka qenë i menjëhershëm dhe në disa raste edhe ka munguar, këto probleme me cilësinë e projektit kanë sjelle vonesa në zbatimin e projekteve.

Gjithashtu, një tjetër problematike shumë shqetësuese ka qenë edhe pajisja me lejen e ndërtimit dhe procedurën për shpronësim, si dhe lirimin e sheshit të ndërtimit, pika të cilat janë detyrime të bashkive bazuar në *Marreveshjen e Investimit* që dy institucionet lidhin në momentin e zbatimit të një objekti, dhe përkohësisht në Nenin 1, pika 1.1 citohet:Objekti i kësaj Marrëveshjeje është financimi i punimeve për realizimin e objektit: “-----” si dhe përcaktimi i detyrimeve të NJVV-së: (i) për lëshimin e lejes së ndërtimit; (ii) për sigurimin e lejeve të tjera administrative të nevojshme për realizimin e projektit;(iii) për përfundimin e çdo procedurë shpronësimi për interes publik duke siguruar financimin e plotë të kostove përkatëse të shpronësimit; (v) për mirëmbajtjen pas realizimit të objektit. *Sa më sipër, trajtuar më hollësisht në faqet nr.44-154 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, rekomandojmë:*

4.1. Rekomandimi: FSHZH të kërkojë vazhdimisht nga Bashkitë dhe në bashkëpunim me strukturat në këto NJQV projekte të plotë dhe me të gjitha elementët e një projekti me qëllim shmangien e rritjes së kostove dhe problematikave në zbatimin e tyre, pa sjellë vonesa në realizimin e veprave të cilat projektohen dhe financohen për të rritur mirëqenien dhe zhvillimin e komuniteteve.

4.2. Rekomandimi: FSHZH të kërkojë vazhdimisht nga Bashkitë, zbatimin Marrëveshjen e Investimit që dy institucionet lidhin në momentin e zbatimit të një objekti, dhe pikërisht në Nenin 1, pika 1.1 citohet: Objekti i kësaj Marrëveshje është financimi i punimeve për realizimin e objektit: “-----” si dhe përcaktimi i detyrimeve të NJVV-së: (i) për lëshimin e lejes së ndërtimit; (ii) për sig urimin e lejeve të tjera administrative të nevojshme për realizimin e projektit; (iii) për përfundimin e çdo procedurë shpronësimi për interes publik duke siguruar financimin e plotë të kostove përkatëse të shpronësimit; (v) për mirëmbajtjen pas realizimit të objektit.

Mosplotësimi i elementëve të mësipërm të parashikohet në kontratën e bashkëpunimit si kusht s’kualifikues për përfitimin e financimit të projekteve nga këto NJQV.

Menjëherë dhe në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi. Nga auditimi në fushën e Prokurimit Publik ku auditimi u krye nëpërmjet sistemit të prokurimit publik derisa nga arkiva u vunë në dispozicion dosjet përkatëse konstatohet se : në kundërshtim me nenin 4 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 Për miratimin e rregullave të prokurimit.

-autoriteti kontraktor në bazë të kërkesave për punë, mallra ose shërbime është përgjegjës për përgatitjen dhe dorëzimin e regjistrave vjetor të parashikimeve për procedurat e prokurimit publik, në përputhje me formën dhe mënyrën e parashikuar në udhëzimet e APP-së. Ky regjistër duhet të përgatitet brenda 10 (dhjetë) ditëve nga miratimi i ligjit për buxhetin. Autoritetet kontraktore, brenda 5 (pesë) ditëve nga hartimi i regjistrave të parashikimit të procedurave të prokurimit, të dërgojnë në organin qendror blerës të dhënat teknike e sasiore dhe fondin përkatës për objektet që do të prokurohen në mënyrë të përqendruar.

Autoriteti kontraktor ka detyrimin të krijojë regjistrin e parashikimeve në sistemin e prokurimit elektronik dhe publikimi i tij nga APP-ja të bëhet brenda tri ditëve nga dita e nesërme e punës nga dërgimi i tij për publikim në sistem.

APP-ja nuk do të lejojë publikimin e regjistrave të parashikimeve, të cilat nuk janë hartuar në përputhje me kërkesat e legjislacionit të prokurimit publik.

Një kopje e regjistrave të parashikimeve pas publikimit nga APP-ja duhet të dërgohet në degën e thesarit dhe në institucionin qendror që vë në dispozicion fondet buxhetore, në rastin kur ka një të tillë. *Sa më sipër, trajtuar më hollësisht në faqet nr.44-154 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, rekomandojmë:*

5.1. Rekomandimi: Njësia e Prokurimit, të marrë masa që njëkohësisht me parashikimet për Buxhetin të hartojë regjistrat përkatës së parashikimit për prokurimet publike me ndryshimet përkatëse të cilat të reflektohen në kohë dhe të jenë të publikuara në Sistemin e Prokurimit Elektronik në APP ,lehtësisht të aksesueshëm nga palët e interesuara.

Në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi. Nga auditimi i procedurave të prokurimit konstatohet se në dokumentet e tenderit të hartuara e miratuara nga AK, nuk është argumentuar vendosja e çdo kriteri për kualifikim, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 61, pika 2 “hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit” ku citohet se: *“Në çdo rast, hartimi i kriterëve për kualifikim dhe specifikimet teknike duhet të argumentohen dhe të dokumentohen në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre”.*

-Nga AK në kriteret e kualifikimeve, Kapaciteti ekonomik dhe financiar kërkon për OE konstatohen raste me kërkesa që nuk nxisin konkurrencën e lirë dhe trajtim të barabartë të operatorëve ekonomik.

-Parashikimet e nenit 46 të LPP, si dhe nenit 26 të VKM nr. 914 datë 29.12.2014, ku çdo kriter i veçantë duhet të jetë në përputhje me natyrën dhe përmasën e kontratës. Vendosija e çdo kriteri duhet të jetë e argumentuar dhe e dokumentuar në përputhje me parashikimet e Ligjit nr. 9643, datë 20/11/2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, Neni 1, si dhe nuk përputhen me natyrën e punimeve dhe volumet e preventivit. *Sa më sipër, trajtuar më hollësisht në faqet nr. nr.44-154 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, rekomandojmë:*

6.1. Rekomandimi: Njësia e Prokurimit, të marrë masa që në procedurat që do zhvillohen në vazhdim në vendosjen e kriterëve kualifikuese si dhe në vlerësimet e ofertave të sigurojnë trajtim të barabartë dhe jo diskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë pjesëmarrës.

Në vijimësi

D. GJETJE ME EFEKTE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN, MENAXHIMIN PA EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE:

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatuan efekteve negative në administrimin e fondeve publike dhe menaxhimin me economicitet, eficence dhe efektivitet të fondeve publike në procedurat e prokurimit publik.

Nga auditimi i procedurave të prokurimit konstatohet se në dokumentet e tenderit të hartuara e miratuara nga AK, nuk është argumentuar vendosja e çdo kriteri për kualifikim, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 61, pika 2 “hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit” ku citohet se: “*Në çdo rast, hartimi i kriterëve për kualifikim dhe specifikimet teknike duhet të argumentohen dhe të dokumentohen në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre*”.

-Nga AK në kriteret e kualifikimeve, Kapaciteti ekonomik dhe financiar kërkon për OE konstatohen raste me kërkesa që nuk nxisin konkurrencën e lirë dhe trajtim të barabartë të operatorëve ekonomik.

-Parashikimet e nenit 46 të LPP, si dhe nenit 26 të VKM nr. 914 datë 29.12.2014, ku çdo kriter i veçantë duhet të jetë në përputhje me natyrën dhe përmasën e kontratës. Vendosija e çdo kriteri duhet të jetë e argumentuar dhe e dokumentuar në përputhje me parashikimet e Ligjit nr. 9643, datë 20/11/2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, Neni 1, si dhe nuk përputhen me natyrën e punimeve dhe volumet e preventivit, nëse AK FSHZH do të udhëhiqej nga parimi në përputhje me parimet e economicitetit dhe eficensës, bazuar kriterëve të vlerësimit që është çmimi më i ulët, autoriteti kontraktor nuk do kishte përcaktuar kriteret e sipërcituara në DST, por kriteret që të nxisin konkurrencën dhe duke vlerësuar çmimin më të ulët, atëherë AK do të kishte mundur të kursente fondet me vlerë më të ulët, në vlerën prej **522,512,769 lekë me TVSH**, vlerë e cila është llogaritur nga grupi i auditimit si rezultat i krahasimit midis ofertës të skualifikuara për shkaqe jo thelbësore në krahasim me objektin e prokurimit me ofertat fituese me të cilat AK ka lidhur dhe kontratat përkatëse. *Sa më sipër, trajtuar më hollësisht në faqet nr. nr.44-154 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, rekomandojmë:*

6.1. Rekomandimi: Fondi Shqiptar i Zhvillimit për cdo procedurë prokurimit të udhëhiqet nga parimi economicitetit, eficensës dhe efektivitetit, bazuar në kriteret të vlerësimit që nxisin konkurrencën e lirë dhe trajtim të barabartë të operatorëve ekonomik, duke përfituar kështu kontrata me çmimi më i ulët dhe kursyer fonde buxhetore.

E. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dosjes teknike të objektit “objektit *"Ndërtim Asfaltim i rrugës Cerrik - Belsh - Grekan"*, u konstatua se operatori ekonomik “V.H” & “V.E” & “E”, sh.p.k” ka përfituar padrejtësisht më tepër vlerën **1,195,065 lekë me TVSH** (456,104 lekë + 539,784 lekë x 20 %), për punime të pakryera dhe të mbivendosura, në kundërshtim me Ligjin 8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”. *Sa më sipër, trajtuar më hollësisht në faqet nr.44-154 të Projekt Raportit të Auditimit, rekomandojmë:*

1.1. Rekomandimi: Fondit Shqiptar i Zhvillimit të ndjekë të gjithë procedurat administrative dhe ligjore për kthimin në Buxhetin e Shtetit të vlerës prej **1,195,065 lekë me TVSH** (456,104 lekë + 539,784 lekë x 20 %), për punime të pakryera dhe të mbivendosura, nga operatori ekonomik “V.H” & “V.E” & “E” .

Menjëherë

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Institucioneve Qendrore. Vendimi dhe Raporti Përfundimtar i Auditimit përcillen në formë rekomandimi në Fondin Shqiptar të Zhvillimit.

Grupi i auditimit:

Marjola Llanaj
Aldo Kume
Eni Kabashi
Mimoza LLoji
